

KONTRATE SHITBLERJE AKSIONESH

Kjo Kontrate Shitblerje Aksionesh (“Kontrata”) e lidhur sot më datë 29.05.2023 nga dhe midis:

BALFIN - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k. (NUIS K72223031K), me seli në adresën: Rruga Papa Gjon Pali II, Ndërtesa Nr. 12, Kati 11, Zyra 1106, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Znj. Edlira Muka e cila vepron në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të shoqërisë, bazuar në Vendimin e Asamblesë të datës 25.05.2023, këtu e në vijim referuar si “Shitësi”,

Dhe

Z. Artan Hoxha, shtetas shqiptar, lindur më 19.11.1964 në Durrës, mbajtës i pasaportës me nr. identifikimi G41119069C, banues në Tiranë, Shqipëri, në vijim referuar si “Blerësi”.

Shitësi dhe Blerësi do të referohen së bashku si “Palët” dhe individualisht si “Pala”.

PREAMBULA

(A) SCAN SHA është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas ligjit shqiptar, me seli në adresën: Rruga Aleksander Moisiu, Ish-Kinostudio, godina e Kinofilmit, Tiranë, e regjistruar në Regjistrin Tregtar me NUIS K12312001A, me kapital të regjistruar 328.732.483,00 Lekë, këtu e në vijim referuar si “Shoqëria”.

(B) Në datën e kësaj Marrëveshjeje, Shitësi zotëron të gjithë kapitalin e regjistruar të Shoqërisë që konsiston në 3,287,325 aksione.

(C) Shitësi ka rënë dakord t’i shesë Blerësit 15% të kapitalit të Shoqërisë që konsiston në 493,099 aksione (këtu e në vijim referuar si “Aksionet”) së bashku me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen me to dhe Blerësi ka rënë dakord të blejë Aksionet nga Shitësi, në përputhje me kushtet dhe subjekt i kushteve të kësaj Kontrate.

(D) Në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje, Blerësi dëshiron të blejë dhe Shitësi dëshiron të shesë dhe transferojë te Blerësi, Aksionet.

PËR KËTË ARSYE, është rënë dakord si më poshtë:

1. PËRKUFIZIMET / INTERPRETIMI

Titujt e të gjitha dispozitave këtu janë vetëm për lehtësi referimi dhe nuk do të ndryshojnë, zgjerojnë ose kufizojnë asnjë nga dispozitat e saj.

2. QËLLIMI I MARRËVESHJES

Në varësi të kushteve të kësaj Marrëveshjeje, Shitësi do t’i shesë Blerësit dhe Blerësi do të blejë nga Shitësi, Aksionet me garanci të plotë dhe të çliruara nga çdo barrë, bashkë me të drejtat dhe detyrimet që lidhen me to.



3. CMIMI I BLERJES SË KUOTËS

- 2.1 Çmimi total i blerjes për Aksionet është 45,000 Euro (dyzet e pesë mijë) ("Çmimi i Blerjes").
- 2.1 Palët kanë rënë dakord se pagesa e Çmimit të Blerjes do të kryhet me transfertë bankare në llogarinë bankare të Shitësit me të dhënat e mëposhtme:
- Përfituesi: BALFIN-Balkan Finance Investment Group Sh.p.k.
- Banka: Tirana Bank
- Nr. Llogarie: 0100307454101
- IBAN: AL11206110040000100307454101
- 2.2 Çmimi i Blerjes do të paguhet i plotë dhe pa ndalesa të çfarëdolloji qofshin në llogarinë e Shitësit, brenda 3 ditëve pune nga data e nënshkrimit të kësaj Kontrate nga të dy Palët.
- 2.3 Nëse Çmimi i Blerjes nuk paguhet i plotë, në mënyrën dhe brenda afateve të përcaktuara këtu më lart, kjo Kontratë do të konsiderohet e pavlefshme.

4. TRANSFERIMI I KUOTAVE

- 4.1 Transferimi i titullit të pronësisë do t'i njoftohet Autoritetit të Mediave Audiovizive në përputhje me parashikimet e nenit 62 të Ligjit 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë".
- 4.2 Pavarësisht njoftimit të lartpërmendur, titulli i pronësisë së Kuotave i transferohet i plotë Blerësit në ditën e kryerjes së pagesës së Çmimit të Blerjes nga Blerësi.
- 4.3 Transferimi i Kuotave do të kryhet në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.
- 4.4 Të drejtat mbi Aksionet do të transferohen tek Blerësi në datën kryerjes së rregullt të pagesës së Çmimit të Blerjes, nga Blerësi tek Shitësi dhe Aksionet do të shiten dhe blihen së bashku me të gjitha të drejtat dhe përfitimet që lidhen me to.

5. DEKLARIME DHE ANGAZHIME

- 5.1 Blerësi deklaron nën përgjegjësinë e tij të plotë se i njej detyrimet që rrjedhin neni 62 të Ligjit 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", për të mos patur pjesëmarrje apo aksione në kapitalet e mediave të tjera audiovizive dhe për të mos zotëruar licenca audiovizive. Blerësi deklaron se nuk ka asnjë të tillë.
- 5.2 Palët deklarojnë se kanë të gjitha autorizimet e nevojshme në lidhje me nënshkrimin e kësaj Kontrate dhe përmbushjen e të gjitha detyrimeve që rrjedhin prej saj.
- 5.3 Shitësi dhe Blerësi autorizojnë Administratorin e Shoqërisë për regjistrimin e transferimit të Aksioneve në Regjistrin Tregtar nën emrin dhe pronësinë e Blerësit duke depozituar, ai vetë apo duke emëruar një përfaqësues të autorizuar, në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) këtë Kontratë si dhe çdo dokument tjetër që mund të jetë i nevojshëm për qëllimin e një regjistrimi të tillë.

6. LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Ky Akt dhe marrëdhënia mes Palëve do të rregullohet nga legjislacioni shqiptar.

7. JURIDIKSIONI

Çdo mosmarrëveshje që rrjedh nga ose lidhet me këtë Kontratë ose ka të bëjë me zbatimin ose vlefshmërinë e saj do të zgjidhet përfundimisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

8. TË NDRYSHME

- 8.1 Palët bien dakord që kjo Kontratë të ndryshohet vetëm me shkrim dhe këto ndryshime të nënshkruhen nga Palët ose nga përfaqësuesit e tyre të autorizuar.
- 8.2 Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Kontrate është ose bëhet, tërësisht ose pjesërisht, e pavlefshme, joefektive, ose e pazbatueshme, vlefshmëria, efektet dhe zbatueshmëria e dispozitave të tjera të Kontratës nuk do të preken. Çdo dispozitë e tillë e pavlefshme, joefektive ose e pazbatueshme do

të konsiderohet e zëvendësuar me një dispozitë të vlefshme, efektive dhe të zbatueshme, që i afrohet qëllimit ekonomik të dispozitës së pavlefshme, joefektive ose të pazbatueshme në lidhje me lëndën, shtrirjen, kohën, vendin dhe fushëveprimin e dispozitës përkatëse. Sa më sipër do të zbatohet mutatis mutandis për çdo boshllëk që mund të gjendet se ekziston në këtë Kontratë.

9. GJUHA DHE KOPJET

Kjo Kontratë nënshkruhet në 3 (tre) njësi origjinale në gjuhën shqipe.

Nënshkruar më 29.05.2023

SHITËSI




Emri: Edlira MUKA

Titulli: Administrator

Në emër të: **BALFIN – Balkan Finance Investment Group SHPK**



BLERËSI



Emri: Artan HOXHA

KONTRATE SHITBLERJE AKSIONESH

Kjo Kontratë Shitblerje Aksionesh ("Kontrata") e lidhur sot më datë 29.05.2023 nga dhe midis:

BALFIN - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k. (NUIS K72223031K), me seli në adresën: Rruga Papa Gjon Pali II. Ndërtesa Nr. 12, Kati 11, Zyra 1106, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Znj. Edlira Muka e cila vepron në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të shoqërisë, bazuar në Vendimin e Asamblesë të datës 25.05.2023, këtu e në vijim referuar si "*Shitësi*",

Dhe

Znj. Dorina Sela, shtetase shqiptare, lindur më 08.10.1987 në Tiranë, mbajtëse e pasaportës me nr. identifikimi I76008057U, banuese në Tiranë, Shqipëri, në vijim referuar si "*Blerësi*".

Shitësi dhe Blerësi do të referohen së bashku si "*Palët*" dhe individualisht si "*Pala*".

PREAMBULA

(A) SCAN SHA është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas ligjit shqiptar, me seli në adresën: Rruga Aleksander Moisiu, Ish-Kinostudio, godina e Kinofilmit, Tiranë, e regjistruar në Regjistrin Tregtar me NUIS K12312001A, me kapital të regjistruar 328.732.483,00 Lekë, këtu e në vijim referuar si "*Shoqëria*".

(B) Në datën e kësaj Marrëveshjeje, Shitësi zotëron të gjithë kapitalin e regjistruar të Shoqërisë që konsiston në 3,287,325 aksione.

(C) Blerësi mban në datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, pozicionin e administratorit të Shoqërisë për një mandat emërimi deri në datën 17.04.2026.

(D) Për shkak të rëndësisë që ka pozicioni që mban Blerësi në Shoqëri, Shitësi ka vendosur t'i shesë Blerësit 15% të kapitalit të Shoqërisë që konsiston në 493,099 aksione (këtu e në vijim referuar si "*Aksionet*") së bashku me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen me to dhe Blerësi ka rënë dakord të blejë Aksionet nga Shitësi në përputhje me kushtet dhe subjekt i kushteve të kësaj Kontrate.

(E) Në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje, Blerësi dëshiron të blejë dhe Shitësi dëshiron të shesë dhe transferojë te Blerësi, Aksionet.

PËR KËTË ARSYE, është rënë dakord si më poshtë:

1. PËRKUFIZIMET / INTERPRETIMI

Titujt e të gjitha dispozitave këtu janë vetëm për lehtësi referimi dhe nuk do të ndryshojnë, zgjerojnë ose kufizojnë asnjë nga dispozitat e saj.

2. QËLLIMI I MARRËVESHJES

Në varësi të kushteve të kësaj Marrëveshjeje, Shitësi do t'i shesë Blerësit dhe Blerësi do të blejë nga Shitësi, Aksionet me garanci të plotë dhe të çliruara nga çdo barrë, bashkë me të drejtat dhe detyrimet që lidhen me to.

3. CMIMI I BLERJES SË KUOTËS

- 3.1 Çmimi i blerjes për Aksionet, për shkak rëndësisë të pozicionit të Blerësit në Shoqëri, përfaqëson një çmim simbolik në vlerën 1 Euro (një) (“Çmimi i Blerjes”).
- 3.2 Palët kanë rënë dakord se pagesa e Çmimit të Blerjes do të kryhet në llogarinë bankare të Shitësit me të dhënat e mëposhtme:
Përfituesi: BALFIN - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k.
Banka: Tirana Bank
Monedha: Eur
IBAN: AL11206110040000100307454101
Nr. llogarie: 0100307454101
Swift: TIRBALTR
- 3.3 Çmimi i Blerjes do të paguhet i plotë në llogarinë e Shitësit, në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate nga të dy Palët.
- 3.4 Nëse çmimi i Blerjes nuk paguhet i plotë, në mënyrën dhe brenda afateve të përcaktuara këtu më lart, kjo Kontratë do të konsiderohet e pavlefshme.

4. TRANSFERIMI I KUOTAVE

- 4.1 Transferimi i titullit të pronësisë do t'i njoftohet Autoritetit të Mediave Audiovizive në përputhje me parashikimet e nenit 62 të Ligjit 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë".
- 4.2 Pavarësisht njoftimit të lartpërmendur, titulli i pronësisë së Kuotave i transferohet i plotë Blerësit në ditën e kryerjes së pagesës së Çmimit të Blerjes nga Blerësi. Transferimi i Aksioneve do të kryhet në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.
- 4.3 Aksionet blihen së bashku me të gjitha të drejtat dhe përfitimet që lidhen me to.

5. DEKLARIME DHE ANGAZHIME

- 5.1 Blerësi deklaron nën përgjegjësinë e tij të plotë se i njeh detyrimet që rrjedhin neni 62 të Ligjit 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", për të mos patur pjesëmarrje apo aksione në kapitalet e mediave të tjera audiovizive dhe për të mos zotëruar licenca audiovizive. Blerësi deklaron se nuk ka asnjë të tillë.
- 5.2 Palët deklarojnë së kanë të gjitha autorizimet e nevojshme në lidhje me nënshkrimin e kësaj Kontrate dhe përmbushjen e të gjitha detyrimeve që rrjedhin prej saj.
- 5.3 Blerësi në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë do të marrë të gjitha masat e nevojshme për regjistrimin e transferimit të Aksioneve në Regjistrin Tregtar nën emrin dhe pronësinë e Blerësit duke depozituar, ai vetë apo duke emëruar një përfaqësues të autorizuar, në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) këtë Kontratë si dhe çdo dokument tjetër që mund të jetë i nevojshëm për qëllimin e një regjistrimi të tillë.

6. LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Ky Akt dhe marrëdhënia mes Palëve do të rregullohet nga legjislacioni shqiptar.

7. JURIDIKSIONI

Çdo mosmarrëveshje që rrjedh nga ose lidhet me këtë Kontratë ose ka të bëjë me zbatimin ose vlefshmërinë e saj do të zgjidhet përfundimisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

8. TË NDRYSHME

- 8.1 Palët bien dakord që kjo Kontratë të ndryshohet vetëm me shkrim dhe këto ndryshime të nënshkruhen nga Palët ose nga përfaqësuesit e tyre të autorizuar.

8.2 Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Kontrate është ose bëhet, tërësisht ose pjesërisht, e pavlefshme, joefektive, ose e pazbatueshme, vlefshmëria, efektet dhe zbatueshmëria e dispozitave të tjera të Kontratës nuk do të preken. Çdo dispozitë e tillë e pavlefshme, joefektive ose e pazbatueshme do të konsiderohet e zëvendësuar me një dispozitë të vlefshme, efektive dhe të zbatueshme, që i afrohet qëllimit ekonomik të dispozitës së pavlefshme, joefektive ose të pazbatueshme në lidhje me lëndën, shtrirjen, kohën, vendin dhe fushëveprimin e dispozitës përkatëse. Sa më sipër do të zbatohet mutatis mutandis për çdo boshllëk që mund të gjendet se ekziston në këtë Kontratë.

9. GJUHA DHE KOPJET

Kjo Kontrate nënshkruhet në 3 (tre) njësi origjinale në gjuhën shqipe.

Nënshkruar më 29.05.2023



SHITËSI



Emri: Edlira MUKA

Titulli: Administrator

Në emër të: **BALFIN – Balkan Finance Investment Group SHPK**

BLERËSI



Emri: Dorina SELA



Transferte midis Llogarive ne monedhe te njejte / Same Currency Account Transfer

Dega/Branch: TIRANA 3 Brryli Data/Date : 31/05/2023 Ora/Time : 13:45:08 Arketari/Teller : B274 Trnx ID : 0000404746701

Detajet te llogarive/Account detailsKlienti qe debitohet/Debit Customer :

SELA DORINA ARBEN
742762

Date Valuta /Value Date
31/05/2023

Numri i llogarise: 0130742762002

Emri i llogarise: DSELA

IBAN: AL56206110350000130742762002

Shuma Debitore/
Debit Amount :

EUR

2.00

Komisioni/
Commission:

EUR

1.00

Shuma Kreditore/
Credit Amount :

EUR

1.00

Pershkrimi/Details:

013000004047467

TRN PER BALFIN - BALKAN FINANCE
KALIM SIPAS KON SHITJE AKSIONESH

Klienti qe kreditohet/Credit Customer :

BALFIN - BALKAN FINANCE
307454

Date Valuta /Value Date
31/05/2023

Numri i llogarise: 0100307454101

Emri i llogarise: BALFIN - BALKAN

IBAN: AL11206110040000100307454101

Pershkrimi/Details

TRN NGA SELA DORINA ARBEN
KALIM SIPAS KON SHITJE AKSIONESH

Dorina Sela
Emer Mbiemer / Firma e Klientit
Customer Signature



Bank Authorized Signatures
Firma/t e Autorizuar/a te Bankes

Me nenshkrimin e ketij dokumenti une deklaroj se fondet e perdorura burojne nga aktivitetet e ligjshme dhe nuk perfaqesojne veprim i cili nuk eshte ne perputhje me ligjin. Banka nuk mban pergjegjesi per gabimet qe rrjedhin nga instruksionet e pasakta te urdheruesit.

1.00 EUR

Item reference : 0022 FFCA 0000558 Posting date 30MAY23
 Transaction code : 520 TRF-Transfer CR Value date 30MAY23
 Account : 0100-307454-101 BALFIN - BALKAN
 Amount : EUR 45,000.00
 Time stamp : 2023-05-30-12.40.10.624000 Statement no.

Reference : DC327932
 Details : Artan Hoxha shitblerje aksionesh
 HOXHA ARTAN HILMI
 0130100989001

Extended narrative

1	8
2	9
3	10
4	11
5	12
6	13
7	14

F1=Help F3=Exit F5=Refresh F12=Previous
 F2=AE F11=AB

